



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Komunikatë

16.07.2013

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e 34-të të radhës të kryesuar nga kryetarja znj. Valdete Daka, ka shqyrtuar dhe miruar një varg çështjesh që lidhen me fillimin e përgatitjeve të KQZ-së për zgjedhjet e 3 Nëntorit. Para se të miratohet rendi i ditës, kryeshefi i SKQZ-së, z. Enis Halimi, ka kërkuar miratimin e Kodit të Mirësjelljes për anëtarët e Komisioneve Komunale Zgjedhore, kurse kryetarja Valdete Daka, ka propozuar për rendin e ditës emërimin e dy anëtarëve të bordit të Planit Operacional të Sigurisë. Fillimisht, kryeshefi Enis Halimi, e ka njoftuar KQZ-në me aktivitetet e fundit. Ai ka thënë se, SKQZ është duke punuar brenda afateve kohore të Planit Operacional, se është në përgatitje e sipër konkursi për stafin jo permanent, i cili do të angazhohet për zgjedhjet lokale. Departamenti i Operacioneve Zgjedhore dhe njësitë e këtij departamenti, janë në proces të aktiviteteve: Koordinimi Teren: përgatitja e emërimit të KKZ-e dhe Caktimi manual i votuesve në Qendrat e Votimit. Njësia e Shërbimit të Votuesve, gjatë krijimit të Listës së Votuesve, me 15.07.2013 ka përgatitur listat për caktim manual të votuesve, gjegjësisht rastet problematike të cilat, nuk mund të caktohen në mënyrë automatike. Kjo tabelë përmban mbi 40 000 raste të cilat, u janë dërguar Zyrtarëve të Lartë Komunal të Zgjedhjeve. Njësia e Shërbimit të Votuesve, i ka draftuar specifikat për shtypjen dhe paketimin e Listave Përfundimtare Votuese. Janë hartuar edhe specifikat për shtypjen, vendosjen dhe shpërndarjen e materialeve të Informimit Publik dhe specifikat për realizimin e dv spoteve, radio spoteve dhe blerjen e hapësirës mediale për transmetim e tv spoteve, dhe të radio spoteve. Në kuadër të organizimit të trajnimit për Zyrtarët e Lartë Komunal Zgjedhorë, Njësia e Shërbimit të Votuesve është në fazën përgatitore për përgatitjen e prezantimeve të Rregullave Zgjedhore. Kurse nga Njësia e Shërbimit të Votuesve, Njësia e Koordinimit në terren, gjegjësisht ZLKZ-ve, u është dërguar Lista me Qendrat e Votimit të vitit 2010. Ky aktivitet, ka të bëjë me Master Listën e QV-ve, dhe VV-e me qëllim të caktimit dhe shpërndarjes së votuesve.

Gjatë kësaj mbledhje, KQZ e ka formuar Këshillin Mbikëqyrës për zbatimin e Strategjisë së Informimit Publik, lidhur me zgjedhjet lokale të 3 nëntorit 2013. Anëtarë të këtij këshilli, janë emëruar: Ilir Gashi, Alban Krasniqi, Binak Vishaj, Ercan Spat, Enis Halimi, Miradije Meha, Haki Krasniqi. Po ashtu, KQZ ka miratuar edhe Kodin e Mirësjelljes për KKZ-të.

Në vazhdim të mbledhjes, kryesuesi i Këshillit për Operacione Zgjedhore, z. Alban Krasniqi, ka paraqitur raportin lidhur me shqyrtimin e anëtarëve të KKZ-ve për 24 komuna. Pas shqyrtimit, KQZ ka kërkuar nga SKQZ-ja që, personat të cilët nuk janë votues të asaj komune në të cilën janë të nominuar, obligohen që ta ndërrojnë Qendrën e Votimit dhe të bëhen votues të asaj komune ku jetojnë, ose të nominohen anëtarë të rinj. KQZ, gjithashtu ka kërkuar nga SKQZ që t'i drejtohet Këshillit Gjyqësor, Prokurorisë së Shtetit dhe PZAP-së që t'i dërgojnë emrat e personave të cilë, janë të dënuar apo janë nën hetime për veprat penale që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.

Kryesuesi i Këshillit për Personel, Florian Dushi, e ka informuar KQZ-në për përgatitjen e Organogramit për angazhimin e stafit jo permanent. Pas shqyrtimit të detajuar, KQZ e ka aprovuar këtë organogram. Në

fund të mbledhjes, është kërkuar që Ueb faqja zyrtare, të pasurohet me sa më shumë me materiale, si dhe të njoftohen mediat për mbledhjet e KQZ-së.

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve